



Stacioni shpirtëror i kënaqësisë ndaj Zotit

Description

Ibn Kajim el-Xheuzije

Ndër vendndalesat e “Ty të adhurojmë dhe ndihmë Ty të kërkojmë” është vendndalesa e kënaqësisë së ëndshme (Rida).

Dijetarët bien në një mendje se kënaqësia është tejet e pëlqyer, por nuk pajtohen sa i përket asaj në qoftë se ajo është obligim, apo jo. Kam dëgjuar Shehun e Islamit, Ibn Tejmije, Allahu e nderoftë shpirtin e tij, që të përçonte të dyja opinionet nga ndjekësit e Imam Hanbelit, por ai kishte prirjen që ta cilësonte kënaqësinë ndaj Zotit të dashur, por jo të detyrueshme. Ai ka thënë: “Asnjë urdhër nuk është dhënë në këtë drejtim, ndryshe nga durimi – i cili është një obligim – (megjithatë), ata që e zotërojnë atë janë të lëvdur.”

Sa i përket transmetimit, apo hadithit, se “[Zoti thotë] cilido që nuk e bart me durim sprovën që Unë i jap dhe nuk është i kënaqur me urdhërin Tim, ai duhet të gjejë një Zot tjetër pos Meje” ai ka vërejtur: “Kjo është me origjinë izraelite dhe nuk është transmetuar në mënyrë autentike nga Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë!”

Unë shtoj se veçanërisht për ata të cilët thonë se ajo është dhunti dhe jo një tipar i përfutur; si mund të jetë ajo vallë e obliguar kur ajo nuk është brenda aftësive të një njeriu?

Zotërinjtë e udhës [së drejtë] janë të ndarë në tre opinione sa i përket kësaj çështjeje:

Horasanët thonë se kënaqësia e ëndshme (rida) përfshihet në kategorinë e stacioneve shpirtërore (mekamat), duke qenë se ajo është etapa e mbrame e teuekulit (të mbështeturit me mirëbesim tek Zoti), dhe mbi këtë pikëpamje, është e mundur që ajo të përftohet.

Irakianët pohojnë se ajo është një nga gjendjet shpirtërore (hal) dhe, prandaj, nuk mund të fitohet, por më saktë ajo zbret mbi zemrën pikërisht sikundër të gjitha gjendjet e tjera. Dallimi midis vendstacioneve dhe gjendjeve është se të parat janë të fituara ndërkohë që të dytat jepen nga Allahu si dhunti.

Një grup i tretë gjykon ndërmjet dy qendrimeve [të lartpërmendura], ndër to autori i *al-Risala* [gjegjesisht, Kushejri], i cili thotë, sikundër thonë edhe disa të tjerë, se fillesa e kënaqësisë fitohet nga robi, dhe mund të cilësohet ndër vendstacionet, por plotësimi i saj është një gjendje, dhe prandaj nuk mund të përftohet. Për rrjedhje, ajo zë fill si një vendstacion dhe përsoset si gjendje.

Ata që e vendosin atë në mesin e stacioneve shpirtërore japin si argument faktin se Zoti ka lëvdur njerëzit që e zotërojnë këtë cilësi dhe i ka nxitur ata drejt saj, gjë që sugjeron se është brenda kapacitetit të tyre për ta arritur atë. Profeti (paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë) ka thënë: “Shijen e fesë e ka shijuar në të vërtetë ai që është i kënaqur me Allahun si Zot, Islamin si fe, dhe Muhamedin si peygamber.” (Muslim # 34.) Ai gjithashtu ka thënë: “Cilido që, me të dëgjuar ezanin, thotë: “Jam i kënaqur me Allahun si Zot, Islamin si fe, dhe Muhamedin si peygamber,” i janë falur atij gjynahet!” (Muslim # 386).

Këto dy hadithe janë boshti i fesë, dhe ata përmbledhin të gjithë fenë. Ata përfshijnë të qenit i mbushur me kënaqësi dhe të qenit i kënaqur me Rububijen dhe Uluhijen, të qenit i kënaqur me Pejgamberin e Tij dhe të qenit i bindur ndaj tij, të qenit i kënaqur me fenë e Tij dhe i nënshtruar ndaj saj. Cilido që i ka të gjitha këto të katra, ai është përnjëmend besimtari më i sigurtë. Një pretendim i tillë është i lehtë [për t’u bërë] me gjuhë, por në realitet [është] më e vështira nga të gjitha gjërat mbarë kur një njeri vihet në sprovë. Veçanërisht kur një njeri përballet me atë që i kundërvihet dëshirës dhe kërkimit të tij, bëhet e qartë se kënaqësia ka qenë e kufizuar në fjalët e atij njeriu dhe jo një realitet.

Të qenit i mbushur me kënaqësi dhe i kënaqur me hyjnishmërinë e Allahut përfshin të qenit i kënaqur me dashurinë, frikën, shpresën, pendimin, dhe devotshmërinë ekskluzive ndaj Tij, duke e bërë Atë objektin unik të kërkimit dhe dashurisë tënde, njëlloj si ai që është krejtësisht i kënaqur me të Dashurin e tij. E gjitha kjo përbëhet nga adhurimi i Tij dhe devotshmëria e papërlyer ndaj Tij.

Të qenit i kënaqur me rububijen e Allahut është të jesh i kënaqur me planin e Tij për robin e tij, si dhe ta besh vetëm Atë objekt të mbështetjes. Kërkimi i ndihmës, dhe burimi i përkrahjes dhe besës nuk është askush tjetër përpos Allahut.

E para e këtyre përbën të qenit i kënaqur me urdhëresat [fetare] të Allahut dhe e dyta është të qenit i kënaqur me dekretet [ekzistenciale] të Zotit.

Të qenurit i kënaqur me Muhamedin (a.s.) si Pejgamber i Tij nënkupton bindje dhe nënshtrim të plotë ndaj tij, ashtu që ai bëhet i parapëlqyer përpara vetes së një njeriu, të mos kërkohet udhëzim përpos në fjalët e tij, të mos kërkohet një gjykatës përpos tij, as të bëhet dikush tjetër një gjykatës mbi mësimet e tij, as të qenit i kënaqur me gjykimin e dikujt pos tij, as në çështjen e Emrave dhe Cilësive të Allahut, as në çështjen e realiteteve të fesë dhe vendstacioneve të saj të ndryshme të përshpirtshme, as në çështjen e gjykimeve të tij, qofshin ato të ndërlidhura me çështjet e jashtme apo ato të brendshme. Në qoftë se një njeri është i pazoti që të gjejë gjykimin e tij, të kthyerit e tij drejt ndonjë burimi tjetër mund të jetë si ai i cili nuk mund të gjejë ndonjë ushqim dhe i kthehet cofëtinës dhe gjakut vetëm si pasojë e nevojës së skajshme, dhe rasti më i mirë do të ishte që ai ta trajtonte atë si dheu për tejmum kur ai e ka të pamundur të gjejë ujë purifikues.

Të qenit i kënaqur me Islamin si fe do të thotë të jesh i kënaqur me atë që feja urdhëron, ndalon, gjykon dhe informon, dhe të mos lejohet që në zemër të ekzistojë paretat apo dyshimi më i vogël në lidhje me të, por t’i nënshtrohet plotësisht asaj, madje edhe në qoftë se kjo është kundër dëshirave apo

planeve të dikujt ose kundër mësimëve të shejhut të dikujt, autoritetit apo *taklidit* (imitimit) të njeriut, apo shkollës së tij.

Në qoftë se arrin ndonjëherë këtë vendstacion, ti do ta gjesh veten tënde të vetmuar në mesin e njerëzve, por jo në gjirin e atyre që janë të huaj në këtë botë. Kështu që të jesh i paralajmëruar dhe mos e lër kurrë veten tënde të ndihesh i vetmuar madje edhe në qoftë se ti lihesh i vetëm në këtë kauzë – sepse kjo, pasha Allahun, është nderi dhe fuqia e vërtetë, dhe ky është çmimi për shoqërinë e Zotit dhe të dërguarit të Tij – kjo është një puhizë e afërsisë së Tij përfundimtare. Kjo është domethënia e të qenit i kënaqur me Atë si Zoti yt, me Muhamedin, mbi të qofshin paqja dhe mëshira, si i Dërguari yt, dhe me Islamin si feja jote.

Në të vërtetë, sa herë që një rob i sinqertë gjen një grimë të ndarjes dhe tëhuajësimi [nga të tjerët] për hir të Zotit dhe shijon shoqërinë ekskluzive të Allahut, ai është i etur për më shumë prej saj, e i lutet Allahut: “O Allah, shtoje tek unë veçimin nga njerëzit, dhe vetminë në dynja, dhe afërsinë me Ty!” Sa më tepër që ai shijon ëmbëlsinë e këtij tëhuajësimi dhe veçimi, aq më tepër fillon të kuptojë se afërsia me njerëzit [e kësaj bote] është vetmia e vërtetë, të qenit i nderuar nga të tillët është poshtërimi i vërtetë, të pajtuarit me opinionet e tyre dhe ndytësinë e mendjeve të tyre është vetë thelbi i injorancës, dhe të ndjekurit e zakoneve dhe konvencioneve të tyre është të qenit vërtet i huaj. Ai nuk ka parapëlqyer ndokënd nga gjërat e krijuara në hisen e tij nga Allahu, as nuk e ka shitur pjesën e tij nga Allahu në këmbim për pajtimin e tyre [njerëzve] në atë që nuk do të shkaktojë asgjë pos humbjes, dhe dobia fundore e të cilit është të fitojë dashamirësinë e tyre në këtë vendbanim tokësor. Kur zinxhiri i shkakësisë merr fund, realitetet kuptohen dhe ajo që është në varre ringjallet dhe ajo që është në kraharore nxirret jashtë, kur të fshehtat zbulohen dhe një njeri nuk gjen asnjë fuqi apo ndihmë përpos në Mbrojtësin [*Valiun*] e Vërtetë, fitimi do të bëhet atëbotë i ndarë nga humbja, dhe ajo që do të ketë vlerë në Peshore do të bëhet e qartë, dhe vetëm Zotit i kërkohet ndihmë dhe mbështetje.

Zgjidhja e çështjes, pra, është se stacioni shpirtëror i kënaqësisë së ëndshme fitohet në lidhje me shkaqet e saj dhe dhurohet në lidhje me thelbin e saj. Sapo një njeri ka fituar shkaqet e saj dhe ka mbjellur farat e saj, ai e vjelë frytin e kënaqësisë prej saj. Sepse kënaqësia është fundi i të teuekullit (mbështetje me mirëbesim) tek Allahu, dhe sapo një njeri zë rrënjë mirë në mbështetje, dorëzim, dhe delegim, kënaqësia do të vijë pashmangshmërisht tek ai. Megjithatë, për shkak të statusit të saj të fuqishëm dhe paaftësisë së pjesës më të madhe të egove për të qenë të prirur drejt saj dhe vështirësisë për ta ruajtur atë, Allahu, në mëshirën dhe prirjen për t’ja lehtësuar robërve të Tij, nuk e ka bërë atë një obligim mbi krijimin. Më saktë, Ai e ka bërë atë të rekomandueshme dhe të lëndueshme, duke premtuar se shpërblimi i kënaqësisë së tyre me Atë në të gjitha gjërat nuk është asgjë më pak sesa kënaqësia e Tij me ata, që është më e madhe dhe më e lartë se Kopshtet (Xhenetet) dhe gjithçka që gjendet në to.

Cilido që është i kënaqur me Zotin e tij, Allahu është i kënaqur me atë; më saktë, kënaqësia e një robi karshi Allahut është një pasojë e kënaqësisë së Allahut me atë. Në të vërtetë, kënaqësia e Allahut me një rob rrethon kënaqësinë e robit nga çdo anë. Sepse është në sajë të kënaqësisë dhe mëshirës së Allahut që robi arrin kënaqësinë. Sapo robi e ka arritur atë, Allahu i përgjigjet duke qenë gjithnjë e më tepër i kënaqur me atë. Kjo është arsyeja përse kënaqësia është më e madhja nga portat drejt Allahut, parajsa e tokës, një shtyrje pa ngut e afatit për të diturit, jeta e të dashuruarve, një begati për adhuruesit, dhe freskia e syve të të devotshmëve.

Më i madhi i shkaqeve lehtësuese të kënaqësisë është që të kapesht pas atyre gjërave që Allahu ka

karakterizuar se janë burimi i kënaqësisë së tij, sepse kjo pa dyshim shpie në shtegun e mbushjes me kënaqësi dhe ëndje.

E pyetën Jahja ibn Muadhin: “Kur e arrin një rob stacionin shpirtëror të kënaqësisë?” Ai tha: “Kur ai e ka ngritur veten e tij mbi katër parime në marrëdhënien me Zotin e tij, ai thotë: “[O Zot] Në qoftë se Ti më jep mua, unë pranoj; në qoftë se Ti më privon mua [nga diçka], unë jam i kënaqur; në qoftë se Ti më lë mua [duke më dhënë kohë të lirë], unë të adhuroj Ty; dhe në qoftë se Ti më thërret mua, unë të përgjigjem.”

Xhunejdi ka thënë: “Kënaqësia është saktësia e diturisë që arrin në zemër, sepse kur zemra ndeshet me realitetin e diturisë, ajo arrin kënaqësinë.”

Kënaqësia dhe dashuria nuk janë si stacionet shpirtërore të shpresës dhe frikës. Sepse kënaqësia dhe dashuria janë dy prej gjendjeve të banorëve të Parajsës, e megjithatë ato nuk ndahen nga kërkimtari në këtë dynja, në gjendjen e ndërmjetme [ndërmjet vdekjes dhe Ditës së Gjykimit], dhe në amshim [*ahiret*]. Frika dhe shpresa, në kontrast, nuk i shoqërojnë punëdrejtët në Parajsë, pasi tani ata e dijnë se e kanë arritur atë që kishin shpresuar dhe e kanë shmangur atë së cilës i frikësoheshin. Ata sërish mund të shpresojnë përjetësisht në bujarinë madhështore të Tij, por një shpresë që nuk ka asnjë fije pasiguri të bashkangjitur në të, por një shpresë pararendëse në një premtim që është i vërtetë nga një i Dashur që është i Gjithëpushtetshëm. Kjo shpresë është e një rendi krejtësisht të ndryshëm në krahasim me shpresën në jetën tokësore.

Ibn ‘Ata’i, Allahu pastë rahmet për të, ka thënë: “Kënaqësia është të gjeturit e qetësisë së zemrës në atë që Zoti ka përzgjedhur përjetësisht për robin si zgjedhja më e mirë e mundshme, dhe kështu ai është i kënaqur me atë.”

Unë shtoj se kjo kënaqësi i përket asaj që është nga Allahu; sa për kënaqësinë me Atë, ajo është edhe më e lartë dhe më fisnike se sa ajo; dallimi ndërmjet një njeriu i cili është i kënaqur me të Dashurin e tij, dhe një njeriu që është i kënaqur me atë që ai merr nga i Dashuri, është pjesa e vetë vetes së tij.

• Kënaqësia kundrejt durimit në vuajtje

Kënaqësia nuk kërkon mungesë të ndjenjës së dhimbjes dhe paretisë, por që një njeri të mos kundërshtojë ose të mos ndjejë hidhërim karshi dekretit të Allahut. Ky dallim ka humbur tek disa njerëz që e refuzojnë në tërësi idenë e kënaqësisë përballë vështirësive si një gjë e panatyrshme, dhe argumentojnë se ajo që kërkohet nuk është asgjë tjetër përpos durimit. Sepse kënaqësia ndaj pakënaqësisë është kontradiktë në vetvete, sepse njëra është e kundërta e tjetrës.

Megjithatë, qendrimi i saktë është se nuk ekziston asnjë kontradiktë ndërmjet tyre, sepse prezenca e pikëllimit dhe e paretisë së vetes nuk e mohon kënaqësinë, siç është kënaqësia e një pacienti me pirjen e një ilaçi të hidhur, apo kënaqësia e një personi agjërues në një ditë të nxehtë me ndjesinë e urisë dhe etjes, kënaqësia e një luftëtari me vështirësitë dhe mundimet që ai ndesh në rrugën e Allahut, dhe kështu me radhë.

Kënaqësia është një rrugë drejt Allahut që është e shkurtër dhe e shpejtë dhe arrin qëllimin më të lartë. E megjithatë, ajo është e lodhshme. Por nuk është më e lodhshme se sa vështirësia në rrugën e

përpjekjes me armë, dhe as nuk ka shtigjet e rrëpirta dhe shkretëtirat që kjo e fundit përmban. Udha e saj e rrëpirtë nuk është asgjë tjetër përpos një dëshirë e lartësuar, shpirt i kulluar, dhe rehatimi i vetes përpara gjithçkaje që vjen nga Allahu. Ajo që e bën atë të lehtë për robin është dija e tij rreth dobësisë dhe pafuqishmërisë së vetes së tij dhe rreth mëshirës, dhembshurisë, dhe mirësisë së Allahut. Kur një njeri i merr në shqyrtim këto dy fakte e megjithatë mënon që ta hedhë veten e tij përpara Allahut në kënaqësi me të gjitha motivimet e dashurisë dhe haresë së nxjerrë prej saj, vetja e tij nuk është e denjë për Allahun, është e larguar prej Tij, jomeritore e afërsisë dhe miqësisë së Tij, ose është një vete e kapluar nga mundimet dhe sprovat. Sepse shtegu i kënaqësisë është një shteg që e bën një rob të hedhë hapa të mëdhenj madje edhe kur ai është në shtratin e tij, dhe kjo e bën atë të parakalojë një kalorës në shumë vendmbërritje.

Fryti i kënaqësi së është lumturia dhe ëndja me Allahun e Plotfuqishëm. Unë kam parë Shehun e Islamit Ibn Tejmije, Allahu e nderoftë shpirtin e tij, në një ëndërr dhe i përmenda atij një çështje në lidhje me aktet e zemrës, dhe vijova më tutje duke përmendur madhështinë dhe dobinë e saj, gjë që nuk do ta cek këtu. Përgjigja e tij ishte: “Sa për mua, udha ime është që të jem i kënaqur dhe i lumtur me Allahun,” ose diçka me këtë kuptim. Kjo ishte gjendja e tij gjatë jetës, siç është e qartë, dhe siç gjendja e tij e bënte të dukshme.

But al-Uasiti^[1] ka thënë: “Vendose kënaqësinë në përdorim sa më mirë që të mundesh, por mos e lër kënaqësinë tënde të vërë ty në përdorim kështu që ti të bëhesh i përlur nga kënaqësia e saj dhe i humbur në të përpara realitetit të asaj që ti sheh.” Ky aluzion i al-Uasitit është një vendkalim tej mase i lodhshëm në sytë e Popullit [sufive], sepse për ata kërkimi i prehjes dhe qetësisë në gjendjet, të ndaluarit në to për hir të kënaqësisë dhe dashurisë, është një perde e madhe ndërmjet tyre dhe Zotit të tyre teksa kënaqësitë e tyre ua mbulojnë sytë nga të vëzhguarit e të drejtave të objektit të dashurisë dhe adhurimit, dhe ky vendkalim i vështirë nuk kapërcehet përpos nga mjeshtrat e mëdhenj.

Al-Uasiti bënte shpesh thirrje për kujdes kundër kësaj sfide dhe paralajmëroi për të [për natyrën e saj tradhtare]. Ai thoshte: “Bëni kujdes se mos ju ëmbëlsohen aktet tuaja të adhurimit, sepse ky është një helm vdekjeprurës.”

Ky, pra, është kuptimi i fjalëve [të Harauit], “vendosja e kënaqësisë në përdorim” por mos e lër atë të të përdorë ty, domethënë, puna jote nuk duhet të ketë për synim që të arrijë ëmbëlsinë e kënaqësisë, aq sa ajo bëhet motivimi yt i vërtetë. Më saktë, bëje atë një instrument dhe shkak në arritjen e qëllimit dhe objektivit tënd, kështu që ti e përdor atë e jo ta lësh atë të të përdorë ty.

Megjithatë, ky paralajmërim nuk është i kufizuar në stacionin shpirtëror të kënaqësisë, por prek të gjitha gjendjet (hal) dhe vendstacionet (mekam) e zemrës në të cilat zemra gjen paqe. Një njeri nuk duhet të punojë drejt dashurisë thjesht për hir të dashurisë dhe ëndjes dhe haresë që e shoqëron atë, por më saktë e përdor dashurinë për të arritur atë që e kënaq të Dashurin; të ndalesh te dashuria do të ishte një mangësi e dashurisë.

Dhu al-Nuni ka thënë: “Ka tri shenja të kënaqësisë: të braktisurit e kontrollit përpara dekretit, të mos kesh asnjë hidhërim mbas dekretit, dhe ekstaza e dashurisë kur mundimi është në kulmin e tij të rëndë.”

I thanë Husjenit, birit të Aliut, Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata, se Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me atë, thotë: “Skamja është më e dashur për mua se sa bollëku, dhe sëmundja më e dashur për mua se sa shëndeti.” Hyseni tha: “Allahu i dhëntë rahmet Ebu Dherrit. Sa për mua, unë them: “Cilido që ia

jep besën mirësisë së zgjedhjes së Allahut për atë, ai nuk dëshiron asgjë tjetër përpos asaj që Allahu ka zgjedhur.”

Fudejl ibn Ijadi i ka thënë Bishr el-Hafit: “Kënaqësia është më e epërme se sa asketizmi [*zuhdi*] karshi kësaj dynjaje, sepse një njeri që është i kënaqur nuk dëshiron asgjë përmbi atë që i është dhënë.”

Ebu Uthmanin e pyetën në lidhje me thënien e Profetit, paqja qoftë mbi të: “Unë e kërkoj kënaqësinë mbas dekretit hyjnor.” Dhe ai tha: “Është kështu sepse të qenurit i kënaqur përpara gjykimit hyjnor [rreth një çështjeje që na kaplon] është vetëm qëllim dhe vendosmëri; kënaqësia e vërtetë është ajo që është mbas gjykimit.”

Është thënë: “Kënaqësia do të thotë të shmangësh ankimin për çdo mundim, çfarëdo qoftë ai.”

“Do të thotë të heqësh dorë nga zgjedhja.”

“Do të thotë të mirëpresësh vendimet me ëndje.”

“Do të thotë qetësi e zemrës me vendimet që merren.”

Omer ibn Hatabi i shkroi Ebu Musa el-Esh’ariut, Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata: “E gjithë mirësia shtrihet në të qenit i kënaqur. Kështu që, në qoftë se ti mundesh, bëje këtë, përndryshe, bëj durim.”

Ebu Ali el-Dakkaku ka thënë: “Njeriu është si një poçe prej dheu që nuk ka asnjë vlerë në qoftë se i kundërvihet caktimit (kaderit) të të Vërtetit të Plotfuqishëm.”

Ebu Othman el-Hiri ka thënë: “Për dyzet vjet Allahu nuk më ka bërë që të qëndroj në një vend ndaj të cilit unë kam pasur mospëlqim, apo nuk më ka bërë që të lëviz drejt një vendi tjetër që unë e kisha zët.”

Kënaqësia është tre lloje. Kënaqësia e njerëzve të zakonshëm me atë që Allahu ka caktuar si kismet për atë dhe ia ka dhënë atij, kënaqësia e elitës me atë që Allahu ka caktuar dhe vendosur, dhe kënaqësia e elitës së elitës me Atë në këmbim për gjithçka tjetër.

- **Kënaqësia dhe prehja në paqe**

Autori i *Menazil* [El-Ensari^[2]] thotë:

“O shpirt i prehur në paqe, kthehu tek Zoti yt, i kënaqur, dhe i pranuar me kënaqësi [*radijeten, merdijeh*]!

Hyr në mesin e robërve të Mi! Hyr në Kopshtin Tim!”

[Ky ajet do të thotë se] Allahu nuk ka lejuar një rrugë drejt Tij për atë që është i meritur. Kësodore, Ai e bëri hyrjen në gjendjen e kënaqësisë një kusht për çdo kërkimtar. Dhe kënaqësia është emri i një ndalese të vërtetë ku [Allahu] e ndalon robin e tij, duke mos kërkuar ai që të lëvizë as para as mbrapa, as të shtojë as të zëvendësojë ndonjë gjendje. Kjo është ndër hapat e parë të elitës dhe më e rrëpirta për njerëzit e zakonshëm.”

Fjalët e tij “Allahu nuk ka lejuar një rrugë drejt Tij për atë që është i meritur” e bejnë rikthimin [e nderuar] të shpirtit në Madhështinë e Tij të varur nga atributi i kënaqësisë, në mungesë të së cilës nuk ka udhë që të shpie drejt Tij. Një shembull i kësaj është në fjalët e të Plotfuqishmit:

[Kështu i shpërblen Allahu ata që kanë drojë] të cilët duke qenë të pastër ngjëjt ua marrin shpirtat duke thënë: “Selamun Alejkum”! – gjetët shpëtimin, hyni në xhenet, për hir të asaj që vepruat” [16:32]

Këtu [Allahu] e ka kushtëzuar marrjen e përshëndetjeve dhe habereve të mira të ëngjëjve nga vdekja e tyre qenë të pastër/të mirë (tajibun). Ky ajet nuk lë hapësirë për një njeri që nuk plotëson këtë kusht që ai të meritojë këtë haber të mirë. Kjo do të thotë se [ideja e Harai-t] arritja e kënaqësisë si një kusht për shpirtin që kthehet te Zoti i tij [me nder], them unë, është e ndërlidhur me aluzionin e ajetit, jo me kuptimin e tij të menjëhershëm. Sepse kuptimi i menjëhershëm i ajetit është kënaqësia e shpirtit me atë që ai ka arritur nga pranimi fisnik dhe bujar [me Zotin e tij], dhe kënaqësinë e Tij me të. Kjo do t’i thuhet atij [shpirtit] në çastin e daljes nga streha e kësaj bote dhe [në çastin e] daljes së tij përpara Allahut.

Abdullah ibn ‘Amr, Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata [babain dhe birin], ka thënë: “Kur një rob besimtar vdes, Allahu dërgon tek ai dy ëngjëj tok me një dhuratë nga Xheneti. Atij i thuhet: “Dil, o shpirt i prehur në paqe, eja në fllad dhe në aromë, dhe tek një Zot që është i kënaqur me ty.” (Raportuar nga Nesaiu nën autoritetin e Ebu Hurejrës [r.a])

Ka tre opinione për sa i përket rastit kur ndodh ky haber i mirë. I pari, dhe më i mirënjohuri, është se kjo do të jetë koha e vdekjes. Hasan el-Basri ka thënë: “Kur Allahu ka për qëllim që ta marrë atë, ai i dorëzohet Zotit të tij në qetësi, i kënaqur me Allahun, dhe kështu Allahu është i kënaqur me atë.”

Opinionin e dytë është se ky haber i mirë do t’i jepet atij në kohën e ringjalljes. Ky është opinionin e Ikrimës, ‘Ata’it, el-Dahhak-ut, dhe i disa të tjerëve.

Opinionin e tretë është se pjesa e parë e kësaj përshëndetjeje, gjegjësisht, “Kthehu tek Zoti yt, i kënaqur, i pranuar me kënaqësi,” do të thuhet në kohën e vdekjes, ndërsa pjesa e dytë, “Hyr në mesin e robërve të Mi! Hyr në Xhenetin Tim!” do t’i thuhet atij në Ditën e Ringjalljes, apo Kijametit. Ebu Salihu ka thënë se “Kthehu tek Zoti yt, i kënaqur, i pranuar me kënaqësi” do të thuhet në çastin e daljes nga dynjaja, ndërkohë që në Ditën e Ringjalljes, do t’i thuhet, “Hyr në mesin e robërve të Mi! Hyr në Xhenetin Tim.”

Opinionin e saktë është se kjo përshëndetje do t’i paraqitet shpirtit të mirë pas largimit të tij nga kjo botë si edhe në Ditën e Ringjalljes. Sepse ringjallja e parë e shpirtit është vdekja e tij. Në atë çast, në qoftë se ai ka qenë i prehur dhe i kënaqur me Allahun, ai do ta gjejë veten në praninë e Shoqëruesit më të Lartë dhe të Xhenetit të Tij. Hadithet e sakta japin argumente për këtë. Më pas, në Ditën e Ringjalljes, ky haber i mirë i jepet [sërish] atij, dhe në këtë mënyrë rikthimi tek Allahu dhe hyrja në Xhenet

plotësohet.

Megjithatë, Shehu [al-Harai] kupton nga ky ajet se rikthimi shpirtit tek Allahu varet nga të qenit i tij i kënaqur. Do të kishte qenë më mirë sikur ai ta kishte përdorur atë për të përkrahur stacionin shpirtëror të prehjes në paqe, sepse kjo gjendje e të qenit i kënaqur dhe i pranuar me kënaqësi i ndodh shpirtit, sipas ajetit, për shkak të prehjes së tij në paqe.

Në do t'i kthehem tani shpjegimit të thënieve të tij.

Thënia e tij “Dhe kënaqësia është ndalesa e vërtetë” do të thotë të ndalosh me atë që Zoti i Plotfuqishëm ka kërkuar në fe pa ngurrim dhe kundërshtim. Kjo kërkohet nga ata që janë në ballë, që është qëndrimi i sigurt me kuptimin dhe kërkesën e synuar të të Vërtetës pa qenë i baltosur nga ndonjë ngurrim apo i penguar nga dëshirat e tua.

Thënia e tij mund të lexohet si “ku një rob ndalon” e tillë që robi është subjekti i foljes, si ku ai ndalon me lejen e Zotit të tij duke mos kërkuar të lëvizë as para as mbrapa. Gjithashtu do të ishte e saktë në qoftë se [robi] lexohet si kundrinë, dhe kjo është më e qartë. Kuptimi tani do të ishte “kudo që Allahu e ndalon robin e Tij” pasi folja *uakafe* mund të përdorej si kalimtare ose si jokalimtare. Kjo do të kishte kuptimin se kudo që Zoti i tij e bën atë të qëndrojë, ai nuk kërkon as të bëjë përpara as të zbrapset. Kjo, megjithatë, duhet t'i referohet kushteve të ndërlidhura me vullnetin ekzistencial të Allahut që nuk i përket urdhërit dhe ndalesës hyjnore; në qoftë se kjo ka pasur domethënien e përcaktimit hyjnor, atëherë përsosmëria shtrihet gjithnjë në kërkimin për të bërë përpara në të. Në qoftë se ai nuk aspiron të bëjë përpara drejt Allahut në çdo çast, ai do të rikthehet në atë që ai nuk e di. Nuk ka qëndrim në mes të rrugës, por në qoftë se ai qëndron në një vend sa i përket pasurisë dhe varfërisë, rehatisë dhe parehatisë apo sëmundjes, apo të qenit në shtëpi apo i pastrehë, ai qëndron atje ku Ai e bën atë të qëndrojë, duke mos kërkuar asgjë tjetër përpos gjendjes që Ai i ka dhënë. Kjo do të thotë të përsosë kënaqësinë e tij me zgjedhjen që Allahu ka bërë për të dhe shuarjen e zgjedhjes së tij në të. E njëjta gjë jetësohet edhe ndaj thënies së tij, “ai nuk kërkon as shtim e as të zëvendësojë një gjendje.”

Kjo pikë që Shehu [al-Harai] ka nxjerrë në pah është një nga llojet e shumta të kënaqësisë, që është kënaqësia sa i përket përcaktimit hyjnor dhe dekreteve ekzistenciale, kundrejt të cilave rezistenca nuk është e urdhëruar.^[3]

Thënia e tij se kjo “është ndër hapat e parë të elitës” do të thotë se duke qenë që udha e elitës është ndarja nga vetja, dhe ndarja nga vullneti është fillimi i ndarjes nga vetja, që është arsyeja përse kënaqësia, në këtë kuptim, është fillimi i udhës së elitës. Kjo ide në thelb është e bazuar mbi qëndrimin e tij se shuarja (fena) është qëllimi përfundimtar i stacionit shpirtëror të kënaqësisë.

Opinionin i saktë, megjithatë, është se kënaqësia është më fisnike dhe më e lartë se sa fena-ja. Kënaqësia është qëllimi, jo fillimi. Përnjëmend, stacioni shpirtëror i mirënjohjes qëndron madje edhe sipër kënaqësisë, e cila është ndërmjet [stacionit të mirënjohjes] dhe stacionit të durimit.

Në fund, thënia [e el-Ensarit] se kënaqësia “është më e rrëpirta për njerëzit e zakonshëm” do të thotë se heqja dorë nga kënaqësitë dhe rehatitë sensuale është gjëja më e vështirë për njerëzit e thjeshtë, dhe kjo është pikërisht kërkesa e parë e arritjes së kënaqësisë.

Tre shkallët e kënaqësisë

El-Ensari ka thënë: **“Ajo ka tre shkallë. Së pari është kënaqësia e njerëzve të zakonshëm, që është kënaqësia me Allahun si Zot dhe pakënaqësi me adhurimin e të gjithë të tjerëve përpos Tij, dhe ky është boshti i Islamit që dëlrëson njeriun nga *shirku* i madh [të mvëshurit ortak Allahut].”**

Kënaqësia me Allahun si Zot do të thotë të mos marrësh padron tjetër përpos Allahut Fuqplotë, në rregullimin e punëve të të Cilit një njeri kërkon prehjen e zemrës së tij dhe tek i Cili një njeri i parashtron nevojat e tij. I Plotfuqishmi ka thënë: “Thuaj: A të kërkoj zot tjetër pos Allahut kur Ai, në të vërtetë, është Zoti i çdo sendi.” [6:164]. Ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me atë, ka thënë [sa i përket kuptimit të fjalës “zot” në këtë ajet]: “Padron dhe hyjni!” Ajo do të thotë, pra: “Si mund të kërkoj unë vallë një zot tjetër pos Tij, i Cili është Zoti i çdo sendi?!” Ai tha në fillimin e Sures: “Thuaj: A mos duhet të marrë unë si aleat [*vali*, mbrojtës] diçka tjetër pos Allahut i cili është filluesi i qiejve dhe i tokës?” [6: 14]. Domethënë, [aleat këtu do të thotë] hyjni, burim i përkrahjes, i ndihmës, dhe i mbrojtjes; ky është lloji i aleancës që lips dashuri dhe bindje. Në mes [të Sures] Ai tha: “A duhet të kërkoj unë gjykatës tjetër pos Allahut kur Ai është që ju ka shpallur juve librin të paraqitur në hollësi?” [6: 114]. Domethënë, “A duhet të kërkoj unë përpos Allahut dikë që do të gjykojë ndërmjet meje e jush dhe të cilit ne mund t’i kthehemi për gjykim?!” Në mënyrë të ngjashme, duke qenë se ky është Libri i zotërisë së të gjithë gjykatësve, si mund të kërkojmë ne vallë gjykim nga një libër pos Librit të Tij, kur Ai e ka zbritur atë si një libër që është i hollësishëm, i qartë, i mjaftueshëm, dhe efikas?!

Kur merrni në shqyrtim siç duhet këto tre ajete ju keni për të parë se [mësimet e tyre] nuk përbëhen nga asgjë tjetër por nga të qenit i kënaqur me Allahun si Zot, Islamin si fe, dhe Muhamedin si i dërguar, dhe ju do të shikoni hadithin^[4] që pasqyron këto [ajete] dhe që ka rrjedhuar prej tyre. Të shumtë janë ata që janë të kënaqur me Atë si Zot dhe nuk kërkojnë zot tjetër përpos Tij, e megjithatë ata nuk janë të kënaqur me të si mbrojtës i tyre, por, më saktë, me padronët e tyre të tjerë pos Tij, duke menduar se ata i afrojnë me Allahun. Patronazhi i tyre është si ata që marrin partonazhin e oborrtarëve të mbretërve. Kjo është pikërisht *shirku* [të mvëshurit ortak]. Monoteizmi i vërtetë do të thotë që një njeri të mos marrë mecenatë të tjerë përpos Tij, dhe Kur’ani është i mbushur me deklarime që karakterizojnë paganët si ata që kanë marrë padronë të tjerë përpos Allahut.

Ky është thelbi i klientelës (mualah) së profetëve dhe të dërguarve të Tij dhe të robërve të Tij besimtarë, sikundër kjo është pjesë e përsosjes së fesë. Klientela e klientëve të Tij është një klasë më vete, dhe marrja e padronëve të tjerë përpos Tij është një klasë krejtësisht e ndryshme. Kush kupton dallimin midis tyre duhet të vihet në kërkim të monoteizmit nga thelbi i tij. Kjo çështje është thelbi dhe esenca e monoteizmit.

Shumë të tjerë kërkojnë gjykatës tjetër përpos Tij, duke kërkuar gjykimin e tij, duke argumentuar në favor të tij, dhe duke qenë të kënaqur me gjykimin e tij. Këto të treja, pra, janë shtyllat e monoteizmit, që një njeri nuk merr asnjë zot tjetër pos Tij, as objekt të adhurimit, as gjykatës.

Ekzegjeza e kënaqësisë me Allahun si Zot është se ti je absolutisht i pakënaqur me adhurimin e të tjerëve pos Tij [kjo do të thotë të jesh i kënaqur me Allahun si Zot, që është përsosmëria e të qenit i kënaqur me Allahun si Zot, sepse cilido që është i kënaqur siç duhet me Allahun si Zot i tij është domosdoshmërisht i pakënaqur me adhurimin e një tjetri]. Sepse të qenit i kënaqur me dëlrësimin e sundimit të Tij lyp dëlrësimin e adhurimit të Tij, pikërisht sikundër njohja e unicitetit të sundimit të Tij lyp njohjen e unicitetit të hyjnishmërisë së Tij.

Thënia e tij “Dhe ky është boshti i Islamit” do të thotë se boshti i Islamit është që një njeri të jetë i kënaqur vetëm me adhurimin ndaj Tij dhe i pakënaqur me adhurimin ndaj dikujt tjetër, dhe është thënë se adhurimi është dashuri me përlësi, dhe kështu që kushdo ndaj të cilit ti je përlulur, ti je bindur, dhe që ti ke dashuruar [të treja njëkohësisht], përpos Allahut, ti je skllav i tij.

Thënia e tij “dhe e dëlirson njeriun nga *shirku* i madh” do të thotë se *shirku* është i dy llojeve, i madh dhe i vogël, kjo kënaqësi e dëlirëson njeriun nga i madhi, sa i përket të voglit, ajo që e dëlirëson nga ai është të zbresë në vendstacionin e “Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.”

Tre kushtet e kënaqësisë

El-Ensari ka thënë: **“Kur tre kushte plotësohen, ka baza [që të thuhet] që Allahu Fuqplotë është më i dashur se të gjitha gjërat për robin, objekti më kryesor i përndërimit të tij, dhe më meritori për bindjen e tij.”**

Kjo nënkupton se ky lloj i kënaqësisë mund të jetë i bazuar vetëm me tre gjëra.

Së pari, që Allahu Fuqplotë është më i dashuri i gjërave të robit, dhe kjo bëhet e ditur nga tre gjëra të mëtejshme. Një, se dashuria e tij është më e madhe në zemër se sa çdo dashuri tjetër dhe çdo objekt tjetër i dashurisë; dy, se dashuria e Tij ia kalon çdo dashurie tjetër, në mënyrë të atillë që dashuria për të gjitha gjërat përpos Tij është e kapërcyer, e kaluar, dhe e përmbajtur në dashurinë e Tij; dhe tre, dashuria për dikë tjetër përpos Tij është e nështruar ndaj dashurisë së Tij. Në këtë mënyrë, Ai është Ai që dashurohet për hir të Tij si objekti më kryesor, dhe dikush tjetër përpos Tij dashurohet në ndjekje të dashurisë së Tij, pikërisht sikundër kujtdo tjetër i bindesh në bindje ndaj Tij. Vetëm Ai në realitet është Ai i të Cilit i bindemi dhe i Dashuruari.

Këto të treja i zbatohen Atij që është objekti më i lartë i përndërimit të një njeriu, si edhe i bindjes gjithashtu.

Për ta përmbledhur, pra, vetëm Ai duhet të jetë i dashuri dhe zotëria më i madh; ai që nuk e do dhe nuk e përndëron Atë nuk i bindet Atij, dhe një person i tillë është arrogant përpara Tij. Kur ai dashuron dhe glorifikon dikë tjetër krahas Atij, dhe i bindet dikujt tjetër krahas Atij, ai është *mushrik* (*idhujtar*). Vetëm kur ai e veçon Atë si pasojë e dashurisë, glorifikimit, dhe bindjes ai është me të vërtetë robi monoteist.

El-Ensari ka thënë: **“Shkalla e dytë është kënaqësia me [\[5\]](#) Allahun, dhe kjo është kënaqësia për të cilën ka folur shpallja, dhe ajo është kënaqësi me Atë në gjithçka që Ai vendos dhe cakton, dhe ky është fillimi i udhëve të elitës.”**

Sheh El-Ensari e ka bërë këtë shkallë më të lartë se sa ajo e fundit. Është kështu sepse një njeri nuk hyn në Islam përpos nëpërmjet shkallës së parë kur këmbët e tij janë të ngulitura në të; sa i përket kësaj shkalle, ajo i takon çështjeve të zemrës dhe është për elitën dhe ka të bëjë me kënaqësinë me gjykimet dhe dekretet e Tij.

Ky është vetëm fillimi i udhës së elitës për shkak se ajo është paralajmërimi i ndarjes nga vetja, gjë e cila është udha e elitës. Ky paralajmërim është fillimi i udhës së tyre pasi kjo e fundit konsiston në

heqjen dorë nga ana e robit nga hisja e tij e kënaqësisë dhe në të qëndruarit me Allahun dhe jo me veten e tij.

Ky është kuptimi i saktë i fjalëve të tij, dhe megjithatë fakti se ai e bën këtë shkallë më të lartë se sa ajo e fundit është qartësisht i hapur ndaj debatit, dhe është analog me faktin që ai e bën durimin nga Allahu më të lartë se sa durimin për Allahun.

Ajo që duhet të jetë e vërtetë është se shkalla e parë është më e lartë dhe më e ngritur në meritë, por kjo shkallë, në të vërtetë, është ambige, pasi kënaqësia me dekretin mund të ndodhë nga një besimtar dhe një jobesimtar [pa dallim], ku qëllimi i saj përfundimtar është dorëzimi ndaj dekretit dhe caktimit të hises së tij nga Allahu. Si është kjo e krahasueshme me të qenurit hareshëm i kënaqur me Allahun si Zot, hyjni, objekt i adhurimit, dhe gjykatës? Kjo kënaqësi është një detyrim, dhe më saktë, është më i madhi i obligimeve [që buron] nga besëlidhja me Bashkësinë. Cilido që nuk është i kënaqur me Atë si Zot, as Islami i tij dhe as veprat e tij nuk janë të shëndosha.

Sa i përket të qenit të kënaqur me caktimin e Tij, shumica e njerëzve pohojnë se kjo është e parapëlqyer dhe jo e detyrueshme. Është thënë gjithashtu se ajo është një detyrim. Këto janë dy opinionet në shkollën e Imam Ahmedit [*medhhebin hanbeli*].

Dallimi ndërmjet këtyre dy shkallëve është dallimi ndërmjet të detyrueshmes dhe të parapëlqyerës, dhe një hadith i shenjtë [*kudsij*] i vërtetë thotë: “Allahu Fuqplotë thotë: Robi im nuk më është afruar Mua me asgjë tjetër më shumë se sa kryerjen e asaj që unë e kam bërë të obligueshme mbi atë.” Kjo tregon se afrimi me Fuqplotin duke zbatuar obligimin është më i epërm dhe më i ngritur se sa i njëjti [afrim] nëpërmjet akteve të vullnetshme [*nafile*].

Krahas kësaj, të qenit i kënaqur me Atë si Zot përfshin, dhe lips, që të jesh i kënaqur me Atë, sepse kjo nënkupton që të jesh i kënaqur me atë çfarë Ai ka urdhëruar dhe ka ndaluar, si dhe me atë që Ai ka dhënë dhe paracaktuar për njeriun dhe ka penguar prej tij. Në qoftë se një njeri nuk është i kënaqur me të gjitha këto, ai nuk mund të jetë i kënaqur dhe i lumtur me Atë si Zot në një mënyrë të plotë, madje edhe në qoftë se ai është i kënaqur me disa aspekte të tij, por të qenurit i kënaqur dhe i lumtur në çdo mënyrë është pa dyshim pjesë e saj.

Gjithashtu, të qenurit i kënaqur me Atë ka të bëjë me Qenien e Tij, Emrat e Tij, dhe Cilësitë e Tij, si dhe me rububijen e Tij si të përgjithshme ashtu dhe të veçanta, ku kjo e fundit është përfshirëse e të qenurit të Tij Krijuesi, Planifikuesi, Prijësi, Ndaluesi, Mbreti, Dhënësi, dhe Mbajtësi, Gjykatësi, Kujdestari, Mbrojtësi, Dhuruesi i ngadhnjimit dhe suksesit, i Mjaftueshmi, Kontrolluesi dhe Mbikëqyrësi, Ai i cili vë në sprovë dhe mbikëqyr, i cili zgjeron dhe ngushton, ndër cilësitë e tjera të të qenurit të Tij Zot.

Sa i përket kënaqësisë me aktet e Tij, kjo përbën kënaqësinë e një robi me atë që Ai bën me të dhe i jep atij, që është [arsyeja] përse [kjo frazë] është shfaqur sa i përket shpërblimit dhe ndëshkimit, si në thënien e Tij: “O shpirt i prehur në paqe, kthehu te Zoti yt, i kënaqur, i pranuar me kënaqësi”: kjo është kënaqësia e vetes me Atë në atë që ka marrë nga bereqeti i tij. Në mënyrë të ngjashme, me fjalët e Fuqplotit: “Shpërblimi i tyre te Zoti i tyre janë Xhenetet e përjetshme poshtë të cilave rrjedhin lumenj, duke rrojtur aty në përjetësi: Allahu është i kënaqur me ata dhe ata janë të kënaqur me Atë. Kjo është për atë që i frikësohet Zotit të tij” [98: 8].

Kënaqësia me Qenien e Tij është thelbi i të qenurit i kënaqur me aktet e Tij; e dyta është fryt i të parës.

E fshehta e këtij rebusi është se kënaqësia me Atë ka të bëjë me Emrat dhe Cilësitë e Tij, ndërkohë që kënaqësia me aktet e Tij ka të bëjë më shpërblimin dhe ndëshkimin e Tij.

Gjithashtu, Profeti e lidhi shijen e besimit me cilindo që është i kënaqur me Allahun si Zot i tij, jo me atë që është i kënaqur me aktet e Tij, siç ka thënë ai: “Besimin me të vërtetë e ka shijuar ai i cili është i kënaqur me Allahun si Zot i tij, me Islamit si fe e Tij, dhe me Muhamedin si të dërguar.” Në këtë mënyrë, ai e bëri kënaqësinë me Atë shoqëruesen e kënaqësisë me fenë e Tij dhe profetin e Tij, dhe këto të treja janë themelet e Islamit pa të cilat ai nuk mund të ekzistojë.

Krahas kësaj, të qenit i kënaqur dhe i lumtur me Atë përfshin afirmimin e njëshmërisë dhe adhurimit të Tij, pendesën para Tij, dhënien e besës Atij, frikën, shpresën dhe dashurinë për Atë, mirënjohjen për begatitë e Tij: pra, duke parë gjithçka që është prej Tij si bereqet dhe begati madje edhe në qoftë se Ai është i ashpër me robin e Tij. Kënaqësia me Atë si Zot përfshin dëshminë se nuk ka zot tjetër përveç Allahut, dhe të qenit i kënaqur me Muhamedin si i dërguar përfshin dëshminë se Muhamedi është i dërguari i Allahut. Të qenurit i kënaqur me Islamit si fe konsiston në të qëndruarit besnik ndaj shërbimit të Tij, dhe në të bindurit ndaj Tij dhe të dërguarit të Tij. Këto të treja së bashku plotësojnë të gjithë fenë.

[1911]

Kënaqësia me atë si Zot përfshin më tutje edhe marrjen e vetëm Atij si objekt i adhurimit dhe si Mbrotjtësin e vetëm, sikundër i Plotfuqishmi i ka thënë të dërguarit të tij: “A mos vallë duhet të kërkoj gjykatës tjetër përpos Tij?” [6: 114] Dhe gjithashtu: “A mos vallë duhet të marrë një Mbrotjtës tjetër përpos Tij?” [6:14] dhe “Thuaj: A më duhet një zot tjetër përpos Allahut në një kohë që Ai është zoti i gjithçkaje?” [6: 124]; ky është thelbi i kënaqësisë me Atë si Zot.

Frytet e Kënaqësisë me Allahun (*Rida*)

Të qenit i kënaqur dhe i lumtur me Allahun, më të Lartësuarin, ka fryte të shumta të besimit, të cilat e ngrejne statusin e një njeriu përpara Tij. Ndër këto fryte të kënaqësisë janë:

Përsosja e adhurimit të Allahut (*ubudijje*) lips kryerjen e asaj që vetja e ulët e një njeriu nuk e pëlqen nga dekretet e Tij. Të kryesh vetëm atë që të pëlqen është e kundërta e të qenit shërbëtor i Zotërisë tënd. Kënaqësia (*rida*) nuk është të jesh i kënaqur vetëm me atë që është këndshme për prirjen e natyrshme [pra, veten kafshërore] por më saktë të jesh i kënaqur madje edhe me ato dekrete të Allahut të cilat i kundërvihen vetes.

Të jesh i kënaqur me Zotin tënd, të Lartësuarin, në të gjitha rrethanat sjellë kënaqësinë e Zotit në këmbim. Në qoftë se një njeri është i kënaqur me Zotin e Tij madje edhe me pak furnizime, Zoti i Plotfuqishëm do të jetë i kënaqur me atë madje edhe me një masë të vogël të veprave të mira.

Pakënaqësia dhe mëria (*sakhat*) [karshi rrethanave ku gjendesh] i hapin derën pikëllimit, ankthit, dhe mjerimit, pështjellimit të zemrës dhe eklipsimit të shpirtit, dhe mendimeve të liga për Zotin, më të Lartësuarin. *Rida*-ja e shpëton një njeri nga të gjitha këto të liga, dhe çel portën e Parajsës së kësaj bote përpara Parajsës së amshimit. Ajo shkakton qetësi, freski të syve dhe prehje të zemrës, ndërkohë

që pakënaqësia sjellë trazim, dyshim dhe shqetësim.

Kënaqësia e bën njeriun që të heqë dorë njëherë e mirë nga kundërvënia ndaj Zotit në urdhërat dhe dekretet e tij. Sepse të qenit i zemëruar dhe i pakënaqur do të thotë të kridhesh në kundërvënie dhe armiqësi ndaj Zotërisë tënd. Pakënaqësia me dekretin e Zotit të tij ishte burimi i armiqësisë së Iblisit karshi Allahut.

Dekreti i Zotit të Plotfuqishëm është i parezistueshëm dhe i pashmangshëm, dhe gjykimi tij është pa dallim i drejtë. Siç thotë një hadith: “Gjykimi Yt është fati im, dhe gjykimi Yt, në rastin tim, drejtësi” (Ahmedi dhe të tjerët) dhe vetëm një zullumqar është i pakënaqur me drejtësinë. “Gjykimi” që përmendet në këtë hadith përfshin paracaktimin sa i përket gjynahut të një robi dhe ndëshkimin rezultues, sepse Ai është më i drejti në të gjithë këtë.

Mund të thuhet se të ndëshkosh një gjynahqar është qartazi e drejtë, por si mund të jetë i drejtë të paracaktuarit e një njeriu që të kryejë gjynahe? Unë them se është kështu për shkak se kryerja e gjynahut është ndëshkimi i Allahut për pavëmendshmërinë e robit karshi Tij, dhe për shmangien e zemrës së tij nga Ai. Zemrat e të pamendve janë miniera të gjynaheve, dhe ndëshkimi u shfaqet atyre nga të gjitha anët e në të gjitha mënyrat. Sepse në qoftë se një njeri është i plotë në sinqeritetin e tij, vëmendjen e tij dhe përkujtimin e tij për Allahun, është e pamundur që ai të kryejë gjynahe. Sikundër thotë Allahu Fuqplotë: “Në këtë mënyrë ne e pengam të ligën dhe zhytjen e paturp në mëkate prej tij, sepse ai ishte ndër robërit tanë të sinqertë.” [Jusuf: 24]

Ju mund të thoni: Përse e ka dekretuar Ai që robi të jetë i pavëmendshëm ndaj Tij, t'i kthejë shpinën Atij, dhe t'i mungojë sinqeriteti që në fillim? Kësaj unë i përgjigjem: e tillë është natyra e vetes njerëzore; në qoftë se Ai, më i Lartësuari, nuk i dëshiron të mirën një robi, Ai e lë atë në mëshirë të vetes së tij të ulët, e cila manifestohet si pavëmendshmëri dhe harresë.

Më pas, ju mund të thoni: Përse e ka krijuar Ai veten njerëzore me një natyrë të tillë? Kësaj unë i përgjigjem: Kjo është një pyetje e pavlerë, sepse fare mirë ju mund të pyesni: Përse nuk e ka bërë Ai atë një engjëll dhe jo njeri?

Në qoftë se ju më pas pyesni: Përse nuk i ka dhënë Ai atij suksesin (*teufik*) nëpërmjet të cilit robi mund ta shpëtojë veten e tij nga e keqja e vetes së tij dhe errësira e natyrës së tij?

Në kundërpërgjigje unë them: Kjo pyetje është si të pyesësh përse Allahu nuk e ka krijuar të gjithë krijimin e Tij të barabartë dhe identik? Përse ka krijuar Ai diferencat dhe të kundërtat? Kjo është më e pavlera e pyetjeve. Ne i kemi shpjeguar tashmë kërkesat e urtësisë së Tij dhe rrjedhojat e Hyjnishmërisë dhe Mbisundimit të Tij.

Mungesa e kënaqësisë tek një njeri mund t'i mvishet ose mungesës së asaj që njeriu dashuron dhe dëshiron, ose përjetimit të asaj që atij nuk i pëlqen. Por duke qenë se është e sigurtë se ajo që i ka shpëtuar atij nuk mund të ketë qenë e tija, dhe ajo që i ka rënë atij mbi krye nuk mund të ishte shmangur, nuk ka asnjë vlerë në të qenit i zemëruar dhe i pakënaqur në lidhje me të.

Kënaqësia çel dyert e sigurisë, duke e ruajtur zemrën ndaj mashtrimit, zemërimit, dhe pështjellimit, dhe askush nuk ka për të gjetur shpëtim nga ndëshkimi Allahut “me përjashtim të atij që sjellë përpara Allahut një zemër të dëlirë”. [26: 89] Sa më e madhe që të jetë kënaqësia e një robi me atë që Zoti i tij i ka dhënë, aq më e madhe është dëlirësia dhe siguria e zemrës së tij. Sepse ligësia, prishja, dhe

mashtimi janë shoqëruesit e pakënaqësisë dhe zemërimit. Në mënyrë të ngjashme, zilia (*hasedi*) është njëra nga frytet e liga të pakënaqësisë së zemrës.

Pakënaqësia i hap derën të dyshuarit tek Allahu, tek paracaktimi i Tij (*kada ue kader*), tek urtësia e Tij, dhe te dija e Tij. Sepse cilido që është i zemëruar dhe i pakënaqur do të gjejë, me një këqyrje nga afër, dyshim dhe dobësi në zemrën e tij. Ky është kuptimi i një hadithi që gjendet tek Tirmidhiu: “Në qoftë se ti mund të veprosh me kënaqësi por edhe me siguri, vepro; në mos, ka shumëçka të mirë kur tregohesh i duruar për vuajtjen tënde.”^[6]

Shkurtimisht, të qenit i kënaqur me atë që Allahu të ka dhënë ty e mbush zemrën me Allahun dhe të qenit i pakënaqur e zbraz praninë e Allahut nga ajo.

Kënaqësia bart frytin e mirënjohjes (*shukr*), e cila është më e larta e stacioneve të besimit, dhe përnjëmend ajo është thelbi i besimit. Pakënaqësia bart frytin e kundërt, i cili është mosmirënjohja karshi dhuntive (*kufr al-ni'am*), dhe me gjasë edhe mohimi i Dhënësit (*kufr al-mu'nim*).

Shejtani e mposht një njeri kryesisht për shkak ose të qenit të tij i pakënaqur ose për shkak të dëshirës së pafre. Kjo është veçanërisht e vërtetë në qoftë se të qenit i tij i pakënaqur apo të qenit të tij i zemëruar bëhet një zakon dhe karakter i rrënjosur thellë. Një njeri i tillë rëndomtazi synon, thotë, dhe bën atë që në sytë e Zotit është e papëlqyeshme. Kjo është arsyeja përse Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi atë, kur i biri i tij Ibrahim ndërroi jetë, ka thënë: “Zemra lëngon, syri derdh lotë, por ne themi vetëm atë që kënaq Zotin.” (Buhariu, Muslimi)

Në fund, të qenit i kënaqur me dekretet e Allahut zbon nga zemra dëshirën dhe epshin e padisiplinuar, sepse ai që është i kënaqur me Zotin e tij e kërkon kënaqësinë jo të vetes së tij të ulët, por të Allahut. Sepse kënaqësia e vërtetë dhe epshi i paligjshëm e kanë të pamundur të bashkëjetojnë në një zemër

Mbasi shpjegon kuptimin e *rida*-së (kënaqësisë me Allahun), Sheh al-Harai thotë në Manazil al-Sa'irin se ka tre shkallë të *rida*-së.

“Shkalla e parë është *rida*-ja e njerëzve të zakonshëm, e cila është të jesh i kënaqur me Allahun (*rida bi'llah*) si Zot, dhe të jesh i pakënaqur me adhurimin e dikujt tjetër pos Tij. Ky është boshti i të gjithë Islamit, i cili e dëlrëson njeriun nga *shirku* më i madh. Kjo shkallë e *rida*-së ka tre kushte: që Allahu i Lartësuar është më i dashur se sa të gjitha gjërat për robin, më i madh se të gjitha gjërat në madhësi dhe përnderim, dhe më i denjë se sa gjithçka tjetër në bindje.”

“Shkalla e dytë është të jesh i kënaqur për Allahun (*rida 'ani'llah*), dhe kjo është përmendur nga shpallja. Ajo është të jesh i kënaqur me gjithçka që Allahu ka vendosur dhe ka caktuar si hise (*kada ue kader*). Ky është fillimi i udhës së elitës. Kjo shkallë ka tre kushte gjithashtu: që të gjitha kushtet [pra, gjëma apo begatia, humbja apo fitimi] bëhen të njëjta për robin, që ai largon tutje çdo pretendim apo armiqësi kundër krijimit, dhe heq dorë nga të lypurit tek të tjerët nga të qenit i varur prej të tjerëve për çdo gjë.”

“Shkalla e tretë është të jesh i kënaqur me kënaqësinë e Allahut (*el-rida bi rida'llah*), e cila konsiston në atë se robi nuk sheh për veten e tij ndonjë kënaqësi apo pakënaqësi, se ai heq dorë nga gjykimi i tij në tërësi, dhe heq dorë nga dallimi [ndërmjet kënaqësisë dhe dhimbjes,

gjëmës dhe begatisë] madje edhe në qoftë se ai do të hynte në zjarr.”

[Imam Ibn Kajjimi shpjegon dhe gjithashtu vlerëson në mënyrë kritike këtë ligjërim gjerë e gjatë dhe paraqet korigjuet të rëndësishëm; pjesë të këtij shpjegimi janë përkthyer në sa vijon. Imam Ibn Kajjimi në thelb argumenton për superioritetin përmbi të gjitha të tjerat të asaj që Sheh Harau i e quan shkalla e parë e përshtatur vetëm për njerëzit e zakonshëm. Kjo është në përputhje me mësimin e përgjithshëm të Ibn Kajjimit dhe mësuesit të tij Ibn Tejmijes se besimi dhe praktika më e mirë janë ato që jepen në Kuran dhe Sunet dhe janë të njohura për të gjithë myslimanët, dhe jo praktikat ezoterike (batini) dhe të fshehta që vetëm një grusht nga elita pretendojnë se i njohin.]

Sheh Harau i e bën [shkallën e dytë] më të lartë se ajo përpara saj, për shkak se, në këndvështrimin e tij, një njeri hyn në Islam vetëm duke përmbushur shkallën e parë [që është të qenit i kënaqur me Allahun si Zot i tij]. Megjithatë, shkallën e dytë ai e konsideron ndër çështjet e zemrës, të cilat janë provincë e elitës, që është të jesh i kënaqur me gjykimet dhe paracaktimin e Allahut për robin. Kjo renditje, megjithatë, është e diskutueshme. Shkalla e parë duhet të cilësohet përnjëmend më e madhe në vlerë dhe domethënie.

[Së pari] Ajo është specifike për besimtarët – vetëm ata janë të kënaqur me Allahun si Zot i tyre, ndërkohë shkalla e dytë mund të përmbushet si nga besimtarët ashtu dhe jo besimtarët, në atë se ata të gjithë e pranojnë atë që Allahu u ka caktuar atyre.

[Së dyti] Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot është një obligim – dhe vërtet, ky është më i madhi i obligimeve pa të cilin Islami i dikujt është i pavlefshëm skundër janë të gjitha aktet dhe adhurimet e tjera. Ndërkohë që të qenit i kënaqur me fatin tënd, sipas opinionit të shumicës, është e rekomandueshme dhe e parapëlqyer, por jo një detyrim. Të tjerë pohojnë se ai është një obligim; të dyja këto opinione gjenden në medhhebin e Imam Ahmedit [Ibn Hanbelit]. Diferenca ndërmjet dy shkallëve, pra, është ajo ndërmjet një akti të detyrueshëm dhe një akti të rekomanduar, dhe në një hadith hyjnor (*hadith ilahi* ose *hadith kudsî*) ne na është thënë se “Robi Im nuk më afrohet Mua me asgjë që ai bën siç më afrohet me përmbushjen e obligimeve të tij” (Buhariu; Ahmedi). Në këtë mënyrë, obligimet janë më të larta se rekomandimet në vlerë dhe domethënie.

[Së treti] Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot përmban të qenit i kënaqur me dekretin e Tij.

[Së katërti] Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot ka të bëjë me Qenin e Allahut, cilësitë dhe emrat e Tij, dhe Hyjnishmërinë e Tij në përgjithësi. Ndërkohë që kënaqësia lidhet me atë që Allahu bën dhe i jep robin. Në këtë mënyrë, të jesh i kënaqur me Allahun (*rida bi'llah*) është themeli i të qenit u kënaqur me dekretet e Allahut (*rida ani'llah*) ndërkohë që kjo e dyta është fryt i të parës.

Thelbi i çështjes është se shkalla e parë, kënaqësia me Allahun, ka të bëjë me emrat dhe cilësitë e Allahut, ndërkohë që shkalla e dytë, kënaqësia, lidhet me shpërblimin e Tij.

[Së pesti] Profeti, paqja qoftë mbi atë, e ka lidhur shijen e besimit me të qenit i kënaqur me Allahun si zot, jo me kënaqësinë, në fjalët e tij: “Cilido që është i kënaqur me Allahun si Zot i tij, Islamin si *dini* i tij, dhe Muhamedin, paqja dhe mëshira qofshin mbi të, si të dërguarin e Tij, ka shijuar shijen e besimit.” (Muslimi)

[Së gjashti] Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot përfshin të dëshmuarit e Njëshmërisë së Tij dhe adhurimit të Tij, të kthyerit kah Ai dhe të mbështeturit mbi Atë, të frikësuarit nga Ai dhe të shpresuarit

dhe të dashuruarit Atë, të qenit i duruar për Atë dhe nga Ai dhe të falënderuarit e Tij për bereqetin [begatitë] e Tij. Të jesh i kënaqur me Allahun është të dëshmosh se nuk ka asnjë të denjë për t'u adhuruar përpos Allahut dhe të jesh i kënaqur me të dërguarin e Tij do të thotë të dëshmosh se Muhamedi është i dërguari i Allahut.

[Së shtati] [Shehu al-Harai] E bën një kusht për këtë shkallë të parë të *rida*-së që Allahu të bëhet për atë më i dashur se gjithçka tjetër, më i përndëruar se sa gjithçka tjetër, dhe më i denjë për bindje se sa gjithçka tjetër. Përsosmëria e dashurisë është prirja e zemrës vetëm drejt të dashurit, gjë e cila çon më pas drejt bindjes dhe pënderimit, dhe sa më e madhe të jetë prirja e dashurisë, aq më e madhe është bindja dhe pënderimi. Cila shkallë mund të jetë më e lartë se sa kjo shkallë! Është kjo ajo për të cilën i Dërguari i Allahut, mbi të qofshin paqja dhe mëshira, thotë: “Tre janë gjërat që në qoftë se gjenden tek një njeri, ai ka shijuar shijen e besimit: që Allahu dhe i Dërguari i Tij janë më të shtrenjtë për atë se sa gjithçka tjetër, që ai dashuron dikë për asnjë arsye tjetër përpos për his të Allahut, dhe që e urren rikthimin në mosbesim mbasi Allahu e ka shpëtuar atë prej tij sikundër ai urren që të flaket në zjarr.” (Buhariu; Muslimi) Kjo dashuri e plotë për Allahun dhe sinqeritet karshi Tij është më e lartë se sa thjesht kënaqësia me kismetin tënd dhe dorëzimi ndaj dekretit të Allahut.

Tre shkallët e *Rida*-së

[Në pjesën e mëparshme, ne paraqitëm kritikën që Imam Ibn al-Kajjimi i bën thënies së Shehut al-Harai se të jesh i kënaqur me dekretin e Allahut është më e lartë se të jesh i kënaqur me të dashuruarit dhe të adhuruarit të Allahut. Sipas Ibn al-Kajjimit, të jesh i kënaqur me të dashuruarit dhe të adhuruarit të Allahut (*rida bi'llah*) është statusi më i lartë, dhe të jesh i kënaqur me dekretin e Allahut është rrjedhojë e saj (*rida ani'llah*). Tani ne i kthehemi përshkrimit që Ibn al-Kajjimi i bën meritave të kësaj shkalle të dytë të *rida*-së.]

[Shehu el-Ensari ka shkruar:] “**Shkalla e dytë është të jesh i i kënaqur për Allahun (*rida ani'llah*), dhe kjo është përmendur nga shpallja. Ajo është të jesh i kënaqur me gjithçka që Allahu ka vendosur dhe ka caktuar (*kada ue kader*). Ky është fillimi i udhës së elitës. Kjo shkallë ka tre kushte gjithashtu: që të gjitha kushtet [pra, gjëma ose begatia, humbja apo fitimi] bëhen të njëjta për robin, që ai largon çdo pretendim kundër krijimit apo armiqësi ndaj krijimit, dhe heq dorë abjures nga të luturit të të tjerëve apo nga të qenit i varur nga të tjerët për çdo gjë.”**

[Imam Ibn al-Kajjimi shkruan:] Fakti që të gjitha kushtet bëhen të njëjta për robin nuk do të thotë se robi është njëlloj i prirur dhe i kënaqur me të gjitha rrethanat me të cilat ai ose ajo është e destinuar nga Allahu që të përballet. Kjo do të ishte në kundërshtim me natyrën njerëzore, dhe, përnjëmend, kundër natyrës së të gjitha gjallesave. Dhe as nuk do të thotë ajo se një njeri është indiferent ndaj gjendjes së tij duke qenë në bindje ndaj Allahut ose në mosbindje, sepse kjo është kundër adhurimit të Allahut në çdo mënyrë. Më saktë, një rob është indiferent ndaj gjëmave dhe dhuntive në mënyrat që vijojnë:

Së pari. Ai [robi i sinqertë i Allahut, besimtari i vërtetë] i ka lënë punët e tij tek Allahu dhe ka mirëbesim tek mëshira dhe urtësia e përkryer e Allahut.

Së dyti. Ai është i sigurtë se nuk ka asnjë ndryshim të mundur në fjalët (caktimet) e Allahut, dhe as nuk mund të sfidojë kush dekretin e Tij. Ajo që ka ngjarë duhet të ngjante, ajo që nuk ka ngjarë nuk mund të ngjante.

Së treti. Ai është vetëm një rob, një skllav. Një rob besnik nuk është kurrë i pakënaqur me urdhërat e

zotërisë së tij të cilin ai e njeh si të mëshirshëm, të urtë, dashamirës, dhe bamirës.

Së katërti. Ai është një i dashuruar, dhe një i dashuruar i vërtetë është ai që është i kënaqur me çfarëdo që zgjedh i dashuri i tij.

Së pesti. Ai është i paditur për përfundimet e gjërave, ndërkohë që zotëria i tij është i gjithëditur, dhe Ai ka dije më të mirë se sa ai vetë se çfarë i bën atij dobi.

Së gjashti. Si një qenie njerëzore, e cila për nga natyra është jo vetëm e paditur por edhe zullumqare, ai nuk dëshiron atë që është në të vërtetë në avantazhin e tij, ndërkohë Zoti i tij i Plotfuqishëm ka për qëllim dobinë e tij të vërtetë dhe ia bën të disponueshme mjetet e saj robit. Dhe më i madhi i mjeteve për dobinë e një njeri është shpesh në gjërat që ai urren, dhe vërtet, dobia e tij në gjërat që ai urren është shumë herë më e madhe se sa dobia në gjërat që ai dëshiron. Allahu Fuqplotë thotë: “Rrokja e armëve është obligim mbi ju ndërkohë që kjo është e urryer për ju: por ndoshta ju e urreni diçka që është e mirë për ju, dhe ndoshta ju e doni diçka që është e keqe për ju. Allahu di, ndërsa ju nuk dini.” (bekare 2:216) Dhe Allahu Fuqploti gjithashtu thotë: “Në qoftë se ju nuk ju pëlqejnë [gratë tuaja], mund të ndodhë se ju nuk e pëlqeni diçka, ndërkohë që Allahu ka bërë për ju në të dobi të shumta.” (Nisa’ 2:19)

Së shtati. Ai është *muslim* (ai që i dorëzohet Allahut), dhe *muslim* është ai që ia dorëzon veten e tij Allahut, dhe nuk i kundërvihet dekreteve të Allahut mbi të, dhe as nuk është ai i pakënaqur me ato.

Së teti. Njohës i Zotit të tij është ai që ka vetëm mendime të mira për Atë.

Së nënti. Ai e di se madje edhe kënaqësia dhe pakënaqësia e tij janë pjesë e asaj që është shkruar për atë.

Së dhjeti. Ai e di se në qoftë se ai është i kënaqur me gjendjen e tij, ajo shndërrohet në një begati për atë dhe mundimet e tij bëhen të lehta për atë. Megjithatë, në qoftë se një njeri është i pakënaqur me gjendjen e tij, ajo bëhet më e vështirë dhe më e rëndë. Profeti, mbi të qoftë paqja, ka thënë: “Pasha Atë në dorë të të cilit është shpirti im, Allahu nuk dekreton për besimtar një dekret përpos që ai është i mirë për të. Në qoftë se ai përjeton një begati, ai është mirënjohës, dhe kjo është e mirë për atë. Në qoftë se ai përjeton gjëmë, ai është i duruar, dhe kjo është e mirë për atë. Dhe kjo nuk është për askënd tjetër përpos për një besimtar.” (Muslimi, Ahmedi)

Së njëmbëdhjeti. Ai e di se plotësimi i të qenit të tij rob (*‘ubudijje*) nuk është e mundur përpos nëpërmjet gjëmave dhe dhimbjes që ai përjeton. Një njeri nuk mund të shijojë frytet e durimit (*sabr*), dhënies së besës (*teuekkul*), kënaqësisë (*rida*), përunjësisë (*tederru*), të qenit nevojtar (*iftikar*), modestisë (*dhu’l-uekhudu*) dhe të tjerave përpos se duke përjetuar ato që ai urren. Të jesh i kënaqur me përfitimet dhe dobitë është, sigurisht, e pakuptimtë, ajo që ka rëndësi është që njeriu është i kënaqur në rast të gjëmës dhe vuajtjes.

E dymbëdhjeta. Ai e di se kënaqësia e tij me dekretin e Zotit të tij në të gjitha situatat i siguron atij kënaqësinë e Zotit të Plotfuqishëm.

E trembëdhjeta. Ai e di se kënaqësia me Zotin e Plotfuqishëm në të gjitha situatat është porta më e madhe drejt dashurisë dhe afërsisë së Tij, dhe një shteg për në Parajsën (Xhenetin) e kësaj bote.

E katërmbëdhjetë. Pakënaqësia, qoftë ajo në dhimbje apo në gjëmë, është udha e hidhërimit, ankthit, pështjellimit të zemrës, dhe çon në mendime qyfyrexhiu në lidhje me Allahun që janë poshtë lavdit të Tij. Virtyti i *rida-së* i largon këto [negativitete] dhe çel derën e Xhenetit të kësaj bote përpara Xhenetit të Amshuar.

Cilido që e mbush zemrën e tij me kënaqësi përballë rrethanave të tij në këtë dynja dhe kënaqësi karshi Zotit të tij, Allahu e mbush kraharorin e tij me paqe dhe pasuri, dhe me dashurinë dhe besën e Tij. Cilido që i mungon një masë e *rida-së*, zemra e tij është e mbushur me të kundërtën e këtyre begative në të njëjtën masë.

Djali e kontrollon qenien njerëzore kryesisht në kohën e ankthit dhe epshit pushtues. Pikërisht aty zë pritë ai me kurthin e tij. Kjo bëhet veçanërisht e vërtetë në qoftë se një njeri zë rrënjë në pakënaqësinë e tij dhe thotë zakonisht gjëra që sjellin pakënaqësinë e Allahut. Profeti, mbi të qoftë paqja, në rastin e vdekjes së birit të tij Ibrahim, tha: “Zemra lëngon, sytë derdhen lotë, por ne nuk do të themi asgjë përpos asaj që i sjellë kënaqësi Zotit.” (Buhariu, Muslimi)

Në këtë rast, ne shohim se zemra e Profetit, mbi të qoftë paqja dhe mëhsira, ka përsosur të gjitha gradat dhe virtytet, dhe kështu zemra e tij është e mbushur me mëshirë (për fëmijën e tij) dhe kënaqësi me Zotin e tij. Njerëzit në këtë çështje mund të ndahen, kësodore, në katër kategori:

Ata që kanë edhe mëshirë [për humbjen e tyre në këtë botë] edhe kënaqësi [sa i përket Zotit të tyre].

Ata që kanë kënaqësi me Zotin e tyre, por kjo ka pakësuar mëshirën e tyre për të tjerët,

Ata që kanë mëshirë për të tjerët, dhe kjo ka pakësuar apo madje edhe eliminuar kënaqësinë e tij me Zotin e tij. [Pjesa më e madhe e njerëzve zemra e të cilëve pikëllohet për vuajtjen e njerëzimit, e humbasin kënaqësinë e tyre këto kohë dhe ata fillojnë të kenë mendime të liga karshi Allahut, duke u bërë krenarë në pakënaqësinë e tyre dhe madje edhe mosbesimtarë karshi Krijuesit të tyre. Ne kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga kjo arrogancë që i jep të drejtë vetes – shënimi i përkthyesit në anglisht]

Në fund, janë ata që nuk kanë as mëshirë [për njerëzit e tjerë] as kënaqësi karshi Zotit të tyre, dhe ky ndoshta është rasti me pjesën më të madhe të njerëzimit: asnjë kënaqësi me të Gjithëmëshirshmin dhe as ndonjë pëlqim drejt krijimit të Tij. Ai, i Plotfuqishmi, është i vetmi burim i ndihmës.

Të qenit i lumtur me Allahun dhe jetën që ai na ka dhënë: Frymëzime nga njerëzit punëdrejtë

Rida-ja, pra, të qenit i kënaqur me Allahun dhe dhuntitë e tij, është një vëlla dhe shoqëruar i sigurisë, pikërisht sikundër pakënaqësia dhe skepticizmi janë shoqëruar të njëri-tjetrit. *Rida*-ja është pjesë bekimi hyjnor (*sa'ade*) që Allahu ia jep si sukses apo hir bijve të Ademit. Sikundër dëgjojmë në Musnedin [e Ahmedit] dhe Tirmidhiun me autoritetin e Sa'd bin Ebi Uekkasit, Allahu qoftë i kënaqur prej tij: “Pjesë e bekimit hyjnor (*sa'ade*) për birin e Ademit është *istikhareja* [namazi i të kërkuarit të bekimit të Allahut në vendimet e tij], dhe pjesë e bekimit hyjnor të birit të Ademit është kënaqësia e tij me atë që Allahu ka caktuar, dhe pjesë e mallkimit hyjnor (*shakaua*) për një bir të Ademit është pakënaqësia e tij me fatin e tij dhe pjesë e mallkimit hyjnor për një bir të Ademit është lënia pas dore e *istikhares*”

.” (Ahmedi; Tirmidhiu; klasifikohet si hadith i dobët).

Një traditë izraelitë thotë se Musai, qoftë mbi të paqja dhe mëshira, e pyeti Zotin e tij të Plotfuqishëm se çfarë e afron atë me kënaqësinë e Tij, për të cilën gjë ai tha: “Kënaqësia ime është në kënaqësinë tënde me dekretin tim.”

Të jesh i kënaqur me dekretin e Allahut [në kohën e humbjes dhe gjëmës] është gjëja më e vështirë mbi veten. Dhe vërtet, është si ta therësh atë. Kjo është arsyeja përse një njeri që vepron kështu meriton kënaqësinë e Allahut, sepse shpërblimi është i të njëjtit lloj si akti. Prandaj, atij do t'i thuhet: “O shpirt i prehur në paqe! Kthehu tek Zoti yt i kënaqur, i pranuar! Hyr në mesin e robërve të Mi. Dhe hyr në Kopshtin Tim.” (Fexhr 27-30)

Pakënaqësia është burimi i të gjithë mosbindjes. Ajo gjithashtu i hap derën edhe risisë fetare (*bidatit*). Mungesa e *rida*-së ishte gjynahu i parë i kryer kundër Allahut në këtë botë, gjegjësisht, refuzimi i Iblisit për t'u përlulur para Ademit.

Njëherë Vuhejb bin el-Uardi, Sufjan el-Theuri, dhe Jusuf bin Asbati u poqën bashkë. Theuri tha: “Deri më sot e kam urreyer vdekjen e papritur. Që tani e tutje, megjithatë, unë parapëlqej vdekjen.” Kur e pyetën përse, ai tha: “Sepse i frikësohem sprovave.” Jusufi tha: “Unë, në krahun tjetër, nuk e konsideroj të papëlqyeshme të jetuarit gjatë.” Kur e pyetën, ai tha: “Mund të ndodhë që mund të has në një ditë në të cilën unë do të pendohem dhe të veprojmë me ndershmëri.” Ata iu kthyen Vuhejbit për opinionin e tij, i cili tha: “Unë nuk parapëlqej as njërën as tjetrën. Ajo që Allahurdo është ajo që unë dua.” Theuri e puthi atë në ballë, dhe tha: “Ky duhet të jetë qëndrimi i shpirtit, pasha Zotin e Qabesë!”

Një njeri duhet të dijë, sikundër tha Sufjan el-Theuri, se privimi ku Allahu e fut një besimtar të vërtetë e të dashur është një dhunti, dhe gjëma e tij është, në të vërtetë, siguri. Sepse Allahu nuk e privon një njeri për shkak të koprracisë apo varfërisë [së Tij], por vetëm për shkak se Ai e cilëson atë më të mirë për robin. Robi, prej paditurisë apo padrejtësisë së tij, nuk sheh asgjë përpos asaj që e kënaq atë aty për aty si begati. Sikur atij t'i jepej një masë e mjaftueshme e diturisë së vërtetë (*marifet*), ai do ta shihte privimin si bekim, gjëmën si mëshirë, dhe do të shijonte mundimet e tij më tepër se sa ç'shijon ai lukset e tij, dhe do të ishte mirënjohës për skamjen madje edhe më tepër se sa ç'është për pasurinë.

Allahu frymëzoi njërin nga profetët e Tij: “Kur të shohësh se po të afrohet varfëria, thuaj: “Mirëseerdhe, o udha e punëdrejtëve!” Dhe kur të thohësh pasurinë, thuaj: “Ah, një gjynah ndëshkimi i të cilit është dërguar paraprakisht!” [Kjo është një traditë izraelitë. Ne duhet të sjellim në kujtesë lutjen e Profetit në të cilën ai kërkoi mbrojtje nga varfëria, dhe se Allahu ia ka përmendur pasurinë Profetit si një bekim: “Dhe ai të gjeti ty në varfëri, dhe të bëri të pasur.” (Duha) Këto thënie duhen kuptuar me ekuilibër dhe kontekst; ato kërkojnë të theksojnë në mënyrë retorike anën zakonisht të pavënëre të gjërave. Allahu na mëson përkoren, apo moderimin, dhe nuk kërkon prej nesh që të shkelim nevojat tona natyrore, por mjaft shpesh, justifikimi që ne i bëjmë ‘natyrës’ shndërrohet në shfajësim për ndjekjen e pamend të dëshirave, dhe lë pak dallim midis nesh dhe jobesimtarëve – përkthyesi në anglisht]

Disa të ditur thonë: “O biri i Ademit, bekimet e Allahut mbi ty në atë që ty nuk të pëlqen janë më të mëdha se sa në atë që ty të pëlqen.” Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe ndoshta ju e përbuzni diçka që është e mirë për ju.” (Bekare 216)

Kënaqësia e Allahut me një rob është më e madhe për robin se sa Xheneti dhe gjithçka që është në të, pasi kënaqësia është një cilësi e Allahut, ndërkohë që Kopshti është krijim i Tij. Allahu më i Larti thotë:

“Dhe kënaqësia nga Allahu është më e madhe” mbasi numëron begatitë që gjenden në (Xhenet). (Teube 76)

Al-Rabi' bin Enes ka thënë: “Shenja e të dashuruarit të Allahut është ta përkujtosh Atë dëndurazi. Sepse ti nuk e dashuron diçka që nuk e përkujton atë dëndurazi. Dhe shenja e fesë është sinqeriteti me Allahun haptazi dhe fshehurazi. Dhe shenja e mirënjohjes është të qenit i kënaqur me dekretin e Allahut dhe nënshtrimi ndaj vullnetit të Tij.”

Ahmed Ebi al-Harai thotë se njëherë i solli në kujtesë Ebu Sulejman el-Daranit hadithin që thotë: “Të parët që do të hyjnë në Xhenet do të jenë ata që thurin lavde [për Allahun] vazhdimisht.” Ai tha: “Kjo nuk do të thotë se ju e lëvdoni Allahun me gjuhët tuaja në kohën kur ju ka rënë gjëma ndërkohë që zemrat tuaja ankohen. Në qoftë se është kështu, atëherë ju duhet të ktheheni në shkallën e durimtarëve. Kjo është shkalla e atyre që lëvdojnë Allahun me zemrat e tyre në nënshtrim dhe kënaqësi.”

Kënaqësia barabitet me shumë akte të mëdha të adhurimit që janë të vështira për trupin; sepse është e lehtë për trupin [por e vështirë për veten, siç është përmendur më herët]. Një traditë izraelite thotë se një adhurues e adhuroi Allahun për një kohë të gjatë, dhe kështu atij iu tregua një bareshë e cila do të ishte shoqja e tij në Xhenet. Kështu, ai u nis që ta kërkonte atë derisa e gjeti dhe kërkoi që të ishte mysafiri i saj për tri ditë në mënyrë që të mund të shihte veprat e saj. Ai zbuloi se ndërkohë që ai falte namaz natën, ajo flinte gjumë, ndërkohë që ai agjëronte, ajo jo, dhe kështu ai i tha asaj në qoftë se ajo bënte diçka tjetër përpos asaj që ai kishte parë me sytë e tij. Asaj nuk po i vinte ndonjë gjë ndërmend, kur më në fund i erdhi diçka: “Unë kam vetëm një cilësi të vockël. Kur jam në vështirësi, nuk dëshiroj lehtësim; kur jam e sëmurë, nuk dëshiroj që të jem e shëndetshme; dhe kur jam në diell, nuk dëshiroj të jem në hije.” Adhuruesi shkundi kryet dhe kuptoi se kjo ishte cilësia që ishte e pakuptueshme për shumë adhurues.

Ibn Mes'udi ka thënë: “Cilido që është i kënaqur me atë që i ka zbritur atij nga qielli është i falur.”

Ndër këshillat që Llukmani i dha të birit ishte: “Të këshilloj të përvetësosh cilësitë që do të ndihmojnë ty të afroresh me Allahun dhe do të shpëtojnë ty nga mëria e Tij: që ti të adhurosh vetëm Atë dhe të mos bësh asnjë të barabartë me Atë, dhe që ti të jesh i kënaqur me dekretin e Allahut në atë që ty të pëlqen dhe në atë që ty nuk të pëlqen.”

Përcillet se Sufjan el-Theuri tha njëherë kur po i bënte një vizitë Rabi'as (nga Basra): “O Allah, ji i kënaqur me ne.” Ajo tha: “A nuk të vjen turp që kërkon kënaqësinë e Allahut ndërkohë ti nuk je i kënaqur me atë?” Mbas kësaj [fjale], Sufjani tha: “O Allah, më fal!”

Është thënë se sa më shumë që të shqetësohesh në lidhje me dynjanë, aq më shumë ke për t'u shqetësuar në amshim, dhe anasjelltas.

Përktheu: Arjol Guni

Referenca

[1] Muhamed b. Musa el-Wasiti (vd. 320), nje prej pjesëtarëve të rrethit të Xhunejd el-Bagdadit.

[2] Shejkh el-islam Ebu Ismail el-Ensari el-Ensari (396-481h) ishte një dijetar dhe një sufi i mirënjohur hanbeli. Ai njihet në botën islame për vepra të shumta shpirtërore si “Menazil Sairin”, “Munaxhat” dhe “Tabekat el-sufijeh”. Në veprën e tij, “Menazil el-Sairin”, el-Ensari e ndan rrugën shpirtërore për tek Zoti në njëqind stacione ose vendqendime. Secili prej tyre ndahet në tre nivele, niveli i njerëzve të thjeshtë, elitës dhe elitës së elitës. Kjo vepër është përzgjedhur nga Ibn Kajim el-Xheuzijeh për tu komentuar në librin e tij “Medarixh el-Salikin bayna manazil ijake na’budu ua ijake nastain”. Ibn Kajimi shpreh një vlerësim të lartë për el-Ensarin dhe shpesh i rezervon atij titullin Shejkh el-Islam. Megjithatë, përgjatë komentit ai jo gjithnjë është dakord me ndarjen dhe analizat e el-Ensarit dhe shpesh ofron analiza kritike ndaj reflektimeve të el-Ensarit.

Në lidhje me el-Ensarin, Ibn Rexhep ka thënë: Ai ishte jurist, mufesir dhe muhadith, hafidh, sufi...” El-Dhehebi e paraqet figurën e el-Ensarit si “Shejkh el-Islami, Imami, shembulli, modeli, mjeshtri i madh i hadithit...shehu i Khorasanit...”. Ndërsa Imam Sujuti e paraqet atë si “Shejkh el-Islami, mjeshtri i hadithit, gnostiku (arif), një prej pasardhësve të Ebu Ejub el-Ensariut” si edhe “Shejk el-Islam, mjeshtri i hadithit, Imami, zahidi (asketiku)...ai ishte një imam, i saktë, i vendosur në ndihmën ndaj Sunetit dhe luftën kundër bidatit” (shën i përk.).

[3] Kjo pikë nga el-Harau dhe pranimi i saj nga Ibn el-Kajim el-Xheuzijeh, nuk është e parëndësishme, nëse e ballafaqojmë atë me imperativin e shkrimit të shenjtë për të kërkuar prosperitet dhe forcë në këtë botë. Për shembull, Kuran 2: 201; 8:60; 11:52 etj. Shqyrto gjithashtu, doktrinën e objektivave të dobishme (maq??id) të sheriatit që dijetarët myslimanë kanë mbështetur prej kohësh.

[4] Referenca është për disa hadithe që përfshijnë këtë formulë, shih për shembull, Muslimin # 386.

[5] Në gjuhën shqipe është e vështirë të shprehësh përmes një parafjale ndryshimin që el-Ensari dëshiron të shprehë midis ra?? bi-llah dhe ri??’an-illah; shprehja e pare thekson të qenit i kënaqur me Qenien e Zotit, ndërsa shprehja e dytë të qenit i kënaqur me veprimet e Tij.

[6] Hadith i panjohur, nuk gjendet tek Tirmidhiu.

Date Created

08/01/2019

Author

erasmusi